

Në bazë të nenit 19, paragrafit 1 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Kosovë nr. 04/L-037, nenit 26 paragrafi 2 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Këshilli Drejtues (KD) i UShAF, në mbledhjen e mbajtur me datën 19.01.2024, mori vendim të shpall:

KONKURS

për zgjedhjen e Rektorit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj

Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet në vijim:

1. Të ketë përvojë të dëshmuar në mësimdhënie akademike, kërkim shkencor dhe të ketë gradën: Profesor i rregullt, Profesor i asocuar ose Profesor asistent.
2. Të ketë përvojë të dëshmuar menaxhuese universitare.
3. Të mos ketë qenë në pozita udhëheqëse në ndonjë parti politike apo në listë zgjedhore të ndonjë partie politike ose koalicioni në nivel qendror apo lokal, në tri (3) vitet e fundit.

Procedura e përzgjedhjes:

- Komisioni profesional, i zgjedhur me shumicë votash nga Senati, ka për detyrë që të verifikojë nëse kandidatët e paraqitur për pozitën e rektorit i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs;
- Për mospranimin e kandidatëve për pozitën e rektorit për shkak të konfliktit të interesit, aplikohen dispozitat e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;
- Komisioni profesional, ia propozon Këshillit Drejtues listën e kandidatëve të cilët i kanë plotësuar kushtet e konkursit për t'u zgjedhur;
- Këshilli Drejtues interviston kandidatët të cilët i kanë plotësuar kushtet për konkurrim në këtë post. Gjatë intervistës, secili kandidat prezanton një vizion gjithëpërfshirës për zhvillimin e strategjisë së ardhshme të Universitetit dhe për çasjen e tij menaxhuese;
- Rektorin e zgjedh Këshilli Drejtues nga lista e kandidatëve të propozuar nga Komisioni profesional prej pesë (5) anëtarëve, të cilin komision e formon Senati;
- Këshilli Drejtues ka të drejtë të refuzojë listën e kandidatëve të propozuar nga Komisioni profesional duke arsyetuar atë;
- Zgjedhja e rektorit bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë të Kosovës, Ligjit për Zyrarët Publik, Statutit dhe Rregullores për punën e Këshillit Drejtues;
- Rektori zgjedhet me shumicën absolute (shumicën e anëtarëve të përgjithshëm të Këshillit Drejtues) në pajtim me dispozitat e Statutit dhe Rregulloren e Punës së Këshillit Drejtues. Në rast se asnjë kandidatë nuk fiton këtë shumicë në radhën e parë të votimit, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave kualifikohen në votimin e dytë.

Nëse, asnjëri nga dy kandidatët nuk fiton shumicën absolute tri herë radhazi, procedura e zgjedhjes përsëritet nga fillimi, siç është paraparë në Statut.

- Emërimi i rektorit bëhet për një periudhë katër (4) vjeçare.

Kandidatët së bashku me kërkesë duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- Biografinë e shkurtër;
- Certifikatën ose ekstraktin e lindjes (originale ose të shkarkuara nga platforma zyrtare e-Kosova);
- Dokumentin e identifikimit (kopje);
- Diplomat apo dëshmitë mbi përfundimin e studimeve pasuniversitare sipas rastit (studimet jashtë vendit) dhe dëshmitë e nostrifikimit të diplomave; (origjinal ose të noterizuara);
- Vendimin/certifikatën apo ekuivalente të titullit akademik (origjinal ose të noterizuar);
- Përmbledhjen e përvojës akademike (në mësimdhënie, kërkime shkencore, krijimtari artistike) dhe përvojën menaxheriale në arsimin e lartë;
- Dëshminë që nuk është i dënuar për ndonjë vepër penale (origjinal ose të shkarkuara nga platforma zyrtare e-Kosova).

Konkurrimi për postin e rektorit është i hapur për kandidatët e brendshëm dhe të jashtëm.

Dokumentacioni i pakompletuar në formë fizike dhe elektronike, dhe i dorëzuar pas afatit nuk do të merret parasysh.

Dokumentet e kompletuara në kopje fizike duhet të dorëzohen çdo ditë pune prej orës 08:00–16:00 në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të UShAF, rruga Universiteti p.n. 70000 Ferizaj- Republika e Kosovës, dhe duhet t'i adresohen Komisionit Profesional të Senatit të UShAF.

Dokumentet e kompletuara, duhet të dorëzohen edhe në formë elektronike (të skanuara) në adresën info@ushaf.net.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në Ueb-faqen zyrtare <https://ushaf.net/konkurs-html/>, përkatësisht nga data: 01.03.2024 deri më datë: 15.03.2024 në ora 16:00.

Intervistimi i kandidatëve të cilët sipas raportit të Komisionit profesional i plotësojnë kushtet për rektor, do të bëhet nga Këshilli Drejtues, me datë: 08.04.2024, duke filluar nga ora 10:00, në ambientet e UShAF, sipas dinamikës së procesit zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme 2024, miratuar nga Këshilli Drejtues, me numër protokolli 133/24, të dates: 19.01.2024.